



www.legjisllacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 20

Tiranë – E hënë, 27 qershor 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 6631, datë 15.4.2016	Me objekt hapjen e procedurës së falimentimit Caktimin e një administratori të përkohshëm të falimentimit Marrjen e vendimit për vetadministrim.....	3



VENDIM
Nr. 6631, datë 15.4.2016

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
FALIMENTIMIT**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

Gjyqtare: Teuta Hoxha

Asistuar nga sekretare gjyqësore Adela Çinari, në datën 15 prill 2016, mori në shqyrtim me dyer të hapura çështjen civile nr. **6631** akti, që u përket:

KËRKUES: “Kurum International” sh.a. me seli në Tiranë, rruga “Ibrahim Rugova”, pall. 14, “Green Park”, ap. nr. 39, kati i 6-të, me administrator z. Ysuf Sezai Kurum, përfaqësuar në seancë me autorizim nga jur. Dardan Mustafaj; jur. Taulant Naço dhe z. Arif Shkalla dhe z. Arjan Rama.

OBJEKTI: Hapje e procedurës së falimentimit.

Caktimi i një administratori të përkohshëm të falimentimit. Marrja e vendimit për vetadministrim.

PERSONA TË TRETË: 1. **Internacional Finance Corporation (IFC)**, përfaqësuar në seancë nga **av. Adriana Shehi Kalo**.

2. **Black Sea Trade and Development Bank**, përfaqësuar në gjykim nga av. Adriana Shehi Kalo, si dhe nga av. Romeo Merruko.

3. **Raiffaissen Bank Albania sh.a. (RFAL)**, përfaqësuar në gjykim nga av. Adriana Shehi Kalo.

4. **Banka Kombëtare Tregtare sh.a.** Tiranë, përfaqësuar nga av. Adriana Shehi Kalo; dhe znj. Veronika Prifti, sipas kërkesës së posaçme të BKT sh.a.

Credit Europe Banka NV, përfaqësuar me prokurë nga av. Dorant Ekmekçiu dhe Jori Bregasi.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 153, 334 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 2, 3, 4, 11/1, 13/3, 14/1, 15, 18, 180, 181/1 dhe neni 233 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”.

Gjykata,

- si dëgjoi raportin e paraqitur prej administratores së përkohshme dhe si shqyrtoi në tërësi kërkesat dhe pretendimet e palëve dhe aktet e paraqitura,

VËREN:

Kërkuesi, shoqëria “Kurum International” sh.a., është shoqëri tregtare, është e regjistruar me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr.

20268, datë 10.11.1998, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në datën 1.12.2006, shoqëria është shndërruar nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në formën juridike, shoqëri anonime me sistem administrimi me dy nivele. Aksionar i vetëm i shoqërisë është z. Hasmet Kurum, zotërues 100% i aksioneve të shoqërisë “Kurum International” sh.a., Këshilli Mbikëqyrës, aktualisht përbëhet nga 3 anëtarë nga të cilët njëri është kryetar.

Shoqëria “Kurum International” sh.a. është regjistruar pranë drejtorisë rajonale tatimore, njësia e tatimpaguesve të mëdhenj dhe e pajisur me NIPT K02727230T.

Objekti i ushtrimit të aktivitetit shtrihet në fushën e: *“Prodhim, tregtim i çeliqueve të ndërtimit e profiëve të tjera të hekurit, importimi dhe eksportimit me shumicë dhe pakicë i mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, konfeksioneve, elektroshtëpiake, karburante e lubrifikante, lëndë të para ndihmëse për industrinë e çelikut e të gjitha mineraleve të tjera. Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit, hoteleri, ndërtime të ndryshme. Prodhim gëlqereje, oksigjen, azot, avull e tregtim të tyre. Prodhim, import-eksport i energjisë elektrike, energjisë diellore dhe energjisë nëpërmjet erës. Grumbullim, demolim, përpunim, tregtim, import-eksport të skrapeve të ndryshme. Prodhim, tregtim me shumicë dhe pakicë, eksport-import i materialeve të industrisë së çeliqueve siç është dhe pa u kufizuar vetëm me to: aliazhet metalike, derdhjet metalike, konstruksionet e çelikut, profilet me saldim dhe të petëzuara, tubat me saldim dhe pa saldim, elementet e tjera të konstruksioneve metalike etj. Prodhim, tregtim me shumicë dhe pakicë, eksport-import, punime sipërfaqësore dhe/ose nëntokësore të produkteve minerare që përdoren si lëndë hyrëse në industrinë metalurgjike. Kërkim, zhvillim, prodhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të gazoil, benzinit, solarit, mazutit, bitumit, gazit të lëngëzuar të naftës (GLN), naftës, gazit dhe të gjitha nënprodukteve të tjera të naftës. Import-eksport dhe përdorim të burimeve të rrezatimit jonizues”.*

Shoqëria “Kurum International” sh.a., ka paraqitur kërkesë në datën 26.2.2016, për fillimin e procedurës së falimentimit duke referuar si shkak ligjor dhe faktit, **paaftësinë paguese në të ardhmen e afërt**, i parashikuar si i tillë në nenin 13, pika 2, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i cili parashikon:

“1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak.

2. Gjendja e paftësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së



falimentimit. Debitori vlerësohet i paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paaftësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryen pagesat.

3. Nëse hapja e procedurës së falimentimit kërkohet nga vetë debitori, ***paaftësia paguese në një të ardhme të afërt përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit***. Debitori ndodhet në gjendjen e paaftësisë paguese në një të ardhme të afërt, kur nuk është në gjendje të paguajë ose të shlyejë detyrimet që ka në datën e maturimit.

4. Mbingarkesa në borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe në bazë të rrethanave pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë...”.

Neni 5 i ligjit parashikon se: “*Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjeve të tjera janë të zbatueshme edhe për procedurën e falimentimit, për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji*”.

Gjykata, pasi u njoh me kërkesën e paraqitur, shpjegimet e dhëna në seancë dhe dokumentacionin e prezantuar nga pala kërkuese, në përputhje me kërkesat e nenit 18, të ligjit “Për falimentimin” caktoi znj. Lindita Kikino, eksperte e falimentit e licencuar me licencën nr. 12 për të vepruar në cilësinë e administratores së përkohshme të falimentimit duke i caktuar detyrat e specifikuar në përmbajtje të këtij neni dhe përkatësisht:

- *Të verifikohet nëse është real shkak për hapjen e procedurës së falimentit;*

- *Të verifikojë nëse është nevojshme të merren masa për sigurimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, likuiditetet dhe pasurisë së debitorit në tërësi;*

- *Të verifikojë nëse ekziston mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë së debitorit;*

- *Të hetojë dhe të paraqesë informacion financiar në lidhje me debitorin (nenet 21 dhe 22 të ligjit);*

- *Të mbikëqyrë veprimtarinë e debitorit në përputhje me nenin 22, pika 2, të ligjit.*

Lidhur me detyrën e parë të shtruar nga gjykata, administratorja e përkohshme ka raportuar konkluzionin se ekziston shkak për hapjen e procedurës së falimentimit, ku si ***shkak i kësaj gjendjeje falimentimi evidentohet paaftësia***

paguese në të ardhmen e afërt. Ky konkluzion i ekspertës analizohet në mënyrë tabelare, duke krahasuar nga njëra anë të ardhurat e pritshme për muajin mars 2016 dhe detyrimet e maturuara për të njëjtën periudhë, pra mars 2016.

Lidhur me detyrën që të verifikojë nëse është e nevojshme të merren masa të mëtejshme për sigurimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, likuiditetet dhe pasurisë së debitorit në tërësi ekspertja ka raportuar se është e nevojshme të merren masa të posaçme për ndalimin e ekzekutimit, sipas parashikimeve të neneve 18 dhe 75, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentin”, i ndryshuar, për shkak të problematikave të dala nga zbatimi i vendimit të gjykatës mbi pezullimin e ekzekutimit gjatë fazës paraprake të shqyrtimit të kërkesës.

Lidhur me detyrën që të verifikohet nëse ekziston mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë së debitorit, ekspertja ka konkluduar se debitori është duke ushtruar veprimtarinë dhe ***ekziston mundësia për vazhdimin e veprimtarisë së debitorit***. Këtë konkluzion, ekspertja e ka mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit financiar të shoqërisë, ndër të tjera: pasqyrave financiare; lista e klientëve dhe e furnitorëve; tabelat analitike të prodhimit dhe shitjes së hekurit dhe energjisë elektrike; gjendjes së magazinës.

Në raportin e paraqitur, ekspertja ka relatuar se shoqëria në tërësinë e aktivitetit të saj dhe sidomos në atë energjetik paraqet tregues pozitivë lidhur me të ardhurat sipas pasqyrave financiare, sektor i cili nuk ka pasur luhatje ndryshe nga ai i prodhimit dhe tregtimit të çelikut. Shoqëria ka paraqitur kërkesë për riorganizim, nëpërmjet procedurës së falimentit për ristrukturimin e detyrimeve me kreditorët sipas një plani riorganizimi.

Administratorja e përkohshme e falimentit, duke vepruar në cilësinë e specialistes ka raportuar se: nga verifikimi i dokumentacionit të shoqërisë rezulton se shoqëria ka ndërprerë prodhimin që prej datës 31.12.2015, ndërkohë ka filluar prodhimi në njërin nga fabrikat, konkretisht në fabrikën e petëzimit në datën 2.4.2016 me dy turne. Gjatë kësaj periudhe shoqëria ka shitur prodhimin e saj të mëparshëm, i cili ndodhej stok në gjendje magazine. Në datën 13 prill 2016 ka rifilluar punën fabrika e çelikut, me një turn e gjysmë.

Mundësia e vazhdimësisë së aktivitetit argumentohet referuar treguesve historikë të



prodhimit dhe çmimeve sipas publikimeve në *site-n SteelOrbis*, për kompanitë e listuara në bursë, si dhe kërkesave të pritshme të tregut në të ardhmen për sa i përket shitjes së hekurit, duke analizuar pritshmëritë për periudhën 2016–2020 në mënyrë tabelare.

Gjithashtu, mundësia e vazhdimësisë së aktivitetit të shoqërisë bazohet referuar të dhënave të prodhimit mesatar dhe çmimin mesatar të energjisë elektrike që prodhojnë hidrocentralet në pronësi të KURUM. Të dhënat janë marrë nga informacionet e publikuara nga HUPLEX nga ku rezulton se për shitjen e energjisë elektrike shoqëria pritet të ketë arkëtimet e mëposhtme, të cilave u duhet zbritur një marzh prej 35% për të marrë në konsideratë variacionet e tregut shqiptar të energjisë elektrike si pasojë e ndryshimeve klimatike, kërkesë së OSHEE-së, koston mesatare të prodhimit (paga, mirëmbajtje etj.) prej rreth 10%, tatim mbi fitimin 15% dhe një marzhi sigurie dhe në total priten arkëtime rreth 15.959 014 euro.

Vjelja e pagesës së energjisë elektrike gëzon siguri shumë të lartë, pasi operatorët blerës janë shoqëri të mëdha me kapitale të mëdha dhe nuk rezulton nga praktika e kaluar që shoqëria të ketë pasur raste blerësish që nuk kanë paguar energjinë e blerë.

Në zbatim të vendimit të gjykatës, datë 16.3.2016, administratorja e përkohshme ka kryer mbikëqyrjen e aktivitetit të debitorit deri në momentin e shpalljes së vendimit mbi kërkesën për falimentim, si dhe ka relatuar problematikat e vërejtura lidhur me zbatimin e vendimit për pezullimin e veprimeve financiare të kryera gjatë periudhës në fjalë.

Gjykata, në bazë të të gjitha të dhënave të marra dhe të përmbledhura si më lart, çmon se kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit është e bazuar për shkak të paaftësisë paguese në të ardhmen e afërt. Gjithashtu, nga tërësia e akteve konkludohet se ekziston mundësia reale për riorganizimin e veprimtarisë së shoqërisë sipas një Plani Riorganizimi.

Gjykata çmon të caktojë si administrator falimentimi znj. Lindita Kikino, me licencë nr. 12 të asistojë debitorin në hartimin e planit të riorganizimit dhe për të kryer detyrat në lidhje me administrimin e shoqërisë deri në miratimin e këtij plani nga Gjykata. Administratori i falimentimit caktohet duke mbajtur parasysh që Plani i

Riorganizimit dhe jo likuidimi parashihet si opsioni për debitorin në këtë procedurë falimentimi.

Në bazë të dispozitave përkatëse të ligjit për falimentimin, deri në fazën e finalizimit/miratimit të Planit të Riorganizimit, shoqëria të vetadministrohet nga debitorin nën kontrollin e administratorit të falimentimit në cilësinë e mbikëqyrësit. Kjo gjendje ligjore presupozon që çdo vendim-marrje duhet të miratohet nga administratori i falimentimit dhe kur ligji e kërkon të detyrueshme nga mbledhja e kreditorëve/Komiteti i Kreditorëve, si dhe të njoftohet ose nëse është rasti të kërkohej miratimi i Gjykatës së Falimentimit në varësi të llojit të veprimit juridik dhe të kërkesave përkatëse të ligjit. Deri në miratimin e Planit të Riorganizimit të mos kryhen pagesa detyrimesh apo veprime juridike me efekt negativ në planin e riorganizimit, përfshirë por pa u kufizuar në asnjë shitje ose blerje asetesh të çdolloji.

Gjatë procedurës së falimentimit, deri në miratimin/finalizimin e planit të riorganizimit, aksionari dhe organi ekzistues përfaqësues i aksionarit me tagra vendimmarrës në shoqëri nuk kanë tagra nga data e vendimit të Gjykatës për hapjen e procedurës së falimentimit dhe deri në miratimin e Planit të Riorganizimit nga Gjykata. Organi vendimmarrës i debitorit në procedurën e falimentimit automatikisht është mbledhja e kreditorëve/Komiteti i Kreditorëve dhe Gjykata e Falimentimit.

Administratorja e falimentimit (mbikëqyrësja), në përputhje me kompetencat ligjore të mbledhë informacionin dhe të përgatisë listën e të gjitha transaksioneve të kryera nga “Kurum International” sh.a., në 3 (tre) muajt e fundit, para datës 26 shkurt 2016, me të drejtën për ta shtrirë këtë verifikim deri në dy vitet e fundit të aktivitetit, të bëjë vlerësimin e duhur mbi mundësinë e anulimit të tyre, si dhe t'i paraqesë për këtë raport Gjykatës së Falimentimit.

Gjithashtu, gjykata çmon që të krijohet Komiteti i Kreditorëve sipas nenit 54/1, të ligjit për falimentimin, duke urdhëruar për këtë thirrjen e mbledhjes së kreditorëve për caktimin e tij para mbledhjes së parë të kreditorëve për raportim.

Në zbatim të nenit 74, pika 12, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, me hapjen e procedurës së falimentimit, ndalohen të gjitha veprimet e ekzekutimit ndaj debitorit. Të gjitha pasuritë dhe shumat e konfiskuara, sekuestruara



apo të fituara nga kreditorë nga shitjet e pasurive të masës së falimentit nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm nga përmbaruesit gjyqësorë, i dorëzohen administratorit të falimentimit nëpërmjet derdhjes ose bërjes së tyre të disponueshme në llogaritë e shoqërisë.

Në interpretim dhe zbatim të dispozitave ligjore, në kushtet kur është hapur procedura e falimentimit për riorganizimin, bankat e nivelit të dytë janë të detyruara të çlirojnë llogaritë e shoqërisë nga sekuestrot konservative apo të ngjashme. Shumat e bëra disponibël në llogaritë e debitorit, të zakonshme ose overdraft, administrohen nga debitori nën mbikëqyrjen e administres së falimentit/organet e tjera të kreditorëve në përputhje me këtë vendim dhe ligjin.

Në përputhje me dispozitat ligjore, vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit shpallet publikisht dhe u njoftohet subjekteve të specifikuar në pjesën urdhëruese të këtij vendimi, si dhe çdo subjekti që administron regjistra publikë pronësie apo të drejta pronësie dhe publikohet sipas përcaktimeve të mëposhtme.

Me hapjen e procedurës së falimentimit, pozita procedurale e personave të tretë sipas pjesës hyrëse të vendimit shndërrohet në pozitën ligjore të kreditorëve të falimentimit duke iu njohur të drejtat sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Konform nenit 127 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 26 e vijues, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008, Gjykata,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Hapjen në orën **10:20**, të datës 15 prill 2016, të procedurës së falimentimit për riorganizim për kërkuar **shoqëria “Kurum International” sh.a.** me NIPT K02727230T, me administrator z. Yusuf Sezai Kurum, me seli në Tiranë, rruga “Ibrahim Rrugova”, pall. 14, “Green Park”, ap. nr. 39, kt. 6.

3. Autorizimin e debitorit shoqëria “Kurum International” sh.a. të administrojë dhe të disponojë pasuritë e masës së falimentimit nën kontrollin e mbikëqyrësit apo administres së falimentimit.

4. Emërimin me statusin e mbikëqyrësit,

administratoren e falimentimit znj. Lindita Kikino, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me nr. licence 12, me adresë veprimtarie, rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara El”, sh. 1, ap. nr. 1, Tiranë.

5. Ngarkohet debitori me hartimin e planit të riorganizimit nën asistencën e mbikëqyrësit.

6. Administratorja e falimentimit (mbikëqyrësi) t’i paraqesë Gjykatës së Falimentimit, raport mbi listën e transaksioneve të kryera nga “Kurum International” sh.a. në 3 (tre) muajt e fundit, të kryejë vlerësimin e duhur ligjor të tyre për mundësinë mbi anulimin e veprimeve juridike sipas kriterëve përkatëse të përcaktuara në ligjin për falimentimin.

7. Të gjitha subjektet që kanë detyrime ndaj debitorit “Kurum International” sh.a., duhet t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë debitorit i cili për çdo rast njofton administratoren e falimentimit.

8. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Kurum International” sh.a. për caktimin e Komitetit të Kreditorëve, të mbahet në datën 18 maj 2016, ora 11:00.

9. Të gjithë kreditorët e shoqërisë kanë të drejtë, brenda datës 15 qershor 2016, të gjitha pretendimet e tyre tek administratorja e falimentimit duke i njoftuar asaj pretendimet dhe të drejtat e siguruar që kanë mbi pasuritë e debitorit. Mbledhja për raportim caktohet në datën 20 qershor 2016, ora 11:00.

10. Mbledhja e kreditorëve të subjektit “Kurum International” sh.a., për verifikimin e pretendimeve mbahet brenda 60 ditëve nga data e mbledhjes për raportim. Data përkatëse e mbledhjes për verifikim vendoset në mbledhjen për raportim.

11. Mbledhja për përcaktimin e së drejtës së votës së kreditorëve për votimin e planit të riorganizimit të mbahet dy javë para datës së mbledhjes që do të caktohet për diskutimin dhe votimin e planit të riorganizimit.

12. Mbledhja e kreditorëve të subjektit “Kurum International” sh.a., për diskutimin dhe votimin e Planit të Riorganizimit të mbahet jo më vonë se 1 muaj nga mbledhja për verifikim. Data e mbledhjes për votimin e Planit të Riorganizimit do të vendoset në mbledhjen e kreditorëve për verifikimin e pretendimeve.

13. Urdhërohet ndalimi i ekzekutimit mbi të gjitha pasuritë e debitorit nga çdo kreditor apo palë e tretë gjatë procedurës së falimentimit, qofshin këto pasuri materiale apo të drejta.



14. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Kurum International” sh.a., në Buletinin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

15. Urdhërohet publikimi dy herë i këtij vendimi, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në adresën zyrtare në internet të palës kërkuese “Kurum International” sh.a. në këtë gjykim, si dhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

16. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Kurum International” sh.a., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

17. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Kurum International” sh.a., t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë, të gjithë kreditorëve të listuar dhe debitorëve të “Kurum International” sh.a.

18. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Kurum International” sh.a., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

19. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Kurum International” sh.a., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar, Autoritetit Portual Shqiptar dhe Zyrës së Regjistrimit të Barrëve siguroese.

20. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Kurum International” sh.a., t’u dërgohet subjekteve të specifikuar në nenin 29, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

21. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit të shkurtuar për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Kurum International” sh.a., në dy gazeta me qarkullim kombëtar.

22. Shpenzimet gjyqësore procedurale në ngarkim të palës kërkuese.

23. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve afat, që për palët prezente fillon nga dita e nesërme e shpalljes dhe për subjektet joprezente nga e nesërmja e marrjes në dijeni.

U shpall në Tiranë, më 15 prill 2016.

GJYQTARE
Teuta Hoxha

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2016